



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.79

Prishtinë, më 13.2.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

**Mungoi:** Sërgjan Popoviq.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2017**

Anëtarët e Komisionit miratuan procesverbalin e mbledhjes së datës 20.1.2017, me vërejtjet e Ismajl Kurteshit dhe Shukrije Bytyçit, që procesverbalet të jenë më përshkruese dhe të përfshijnë të gjitha çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit.

### **3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë**

Nait Hasani, kryetar, foli në pika të shkurtra për gjetjet e raportit të monitorimit, duke theksuar aktivitetet që Komisioni ka ndërmarrë së bashku me Demokraci+ (D+), me të cilën ka pasur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje. Ai tha se diskutimet janë zhvilluar me të gjitha grupet e interesit, kryetarët e komunave, drejtorët e drejtorive përkatëse si dhe me organizatat e ndryshme që mbështesin rininë. Ai shtoi se temat kryesore që kanë zhvilluar në terren kanë qenë zbatueshmëria e Ligjit për Rini, puna vullnetare, licencimi i qendrave rinore, edukimi joformal si dhe pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje. Një kërkesë e dalë nga këto diskutime në terren ishte edhe plotësim-ndryshimi i udhëzimeve administrative të tanishme.

Kryetari Hasani, para anëtarëve të Komisionit i lexoi rekomandimet e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, ku vuri theksin tek rekomandimi që ka të bëjë me ndarjen e një kodi të veçantë buxhetor për rininë nga Ministria e Financave, dhe kjo sipas tij mund të bëhet përmes Asociacionit të Komunave, pasi që është kërkesë e dalë nga të gjitha debatet e realizuara dhe si rrjedhojë, sipas tij, kjo do t'i obligonte komunat që të bëjnë një gjë të tillë, sepse siç është tani, ajo u është lënë komunave në vullnet të lirë të ndajnë apo jo këtë kod.

Në fjalën e tij, Bekim Haxhiu, propozoi që mbështetja financiare dhe institucionale e qendrave rinore të bëhet varësisht nga aktivitetet dhe performanca e tyre.

Ndërkaq, Sali Morina vlerësoi punën e bërë nga Komisioni për këtë Ligj. Ai shtoi se një mangësi e dukshme është ajo e menaxhimit të duhur të këtyre qendrave rinore në nivel lokal dhe si vijim, ai propozoi që të gjendet mundësia e angazhimit të një personi që do të kujdesej për qendrën rinore në komunën përkatëse.

Shpejtim Bulliqi, paraqiti dy rekomandime. Ai tha se rekomandimi që Komuna të themelojë komisionet për vlerësimin e projekteve të organizatave rinore, duhet të kihet parasysh, në mënyrë që të shmangët ndikimi politik i kryetarit të Komunës, duhet që të përcaktohet përbërja e këtij komisioni, i cili do të duhej të dominohej nga organizatat rinore. Ndërkaq, propozimi i dytë i tij pati të bëjë më pozitën e personit që do të angazhohej për menaxhimin e qendrës rinore, ku siç tha ai, duhet të gjendet forma që ai të mos ndërrohet sa herë që ndërrohet stafi udhëheqës i qendrës dhe ai do të ishte mirë që të jetë për një periudhë të gjatë, pasi që do të ruhej vazhdimësia e punës.

Teuta Haxhiu, foli për rekomandimet që kanë të bëjnë për themelimin e Komisionit për punë vullnetare, për të cilën tha se kjo është një e dalë edhe nga diskutimet e zhvilluara në terren dhe se kësaj çështjeje do të ishte mirë që t'i vihen afate se kur duhet të bëhet kjo apo edhe të hartohet një ligj i veçantë për vullnetarizmin.

Salih Morina shtoi se, sa i përket Udhëzimit Administrativ për Punën Vullnetare, Ministria e ka nënshkruar këtë udhëzim para më shumë se një muaji dhe se tani ai është në zbatim. Më tej, ai shtoi se e përkrah idenë dhe propozimin e dalë edhe nga debatet e ndryshme në terren që të kemi Ligj të veçantë për vullnetarizëm, pasi që një gjë të tillë e kanë edhe vendet e rajonit.

Ismajl Kurteshi, tha se ka dy çështje të rëndësishme për të ngritur. E para, pati të bëjë me mirëmbajtjen e qendrave rinore lokale dhe me nevojën e përcaktimit të mbikëqyrësit të kësaj qendre brenda komunës. Ai tha se përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve do të duhej të ishte Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Më tej, ai propozoi që sa i përket numrit të qendrave rinore që Komuna duhet t'i licencojë, duhet të jenë së paku dy qendra, duke e arsyetuar këtë me krijimin e mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirëse në përfaqësim.

Bekim Haxhiu, tha se, Ligji obligon Komunën që të licencojë së paku një qendër rinore, por nëse ka nevojë, Komunitat mund të licencojnë edhe më shumë. Ai shtoi se Këshillat e Veprimit Rinor Lokal, do të duhej që në fund të çdo viti të paraqesin aktivitetet e realizuara nga ta dhe në bazë të rangimit dhe të performancës, të përfitojnë mjetet për aktivitetet e vitit vijues, pasi që në këtë mënyrë do t'i nxiste edhe qendrat që janë ma pasive, të nxiten dhe të jenë më aktive.

Shukrije Bytyçi, theksoi se Ligji për Vullnetarizëm duhet të jetë pikë kryesore e këtij raporti dhe bëri thirrje që të hartohet ky ligj sa më shpejt të jetë e mundur. Ajo shtoi se duke marrë parasysh kërkesën e institucioneve shtetërore dhe private, që në konkurset e tyre të plotësohet kriteri i përvojës së punës, bëri thirrje që t'i krijojnë këto mundësi për të gjithë të interesuarit dhe që kjo përvojë të dëshmohet me dokumente të lëshuara nga këto institucione.

Në vazhdim, u vendos që përbërja e Komisionit vlerësues për projekte në nivel komunal të përbëhet nga asamblatë komunale me përfaqësimin gjithëpolitik, në mënyrë që të shmangen konfliktet e interesit që do të mund të shkaktonte pjesëmarrja e KVRL-ve pasi që u tha që kjo do t'i mundësonte atyre vlerësimin e projekteve të tyre.

Shpejtim Bulliqi, propozoi të përcaktohet numri i anëtarësisë, në mënyrë që të duhet se sa personave iu shërben mirëmbajtësi i qendrës.

Komisioni, pas diskutimeve lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë nxjerrë këto:

#### **Rekomandime**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë Udhëzimin Administrativ, sipas nenit 6 paragrafi 2, me të cilin përcaktohen ministrinë kyçe përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë Ligj të veçantë për punën vullnetare;
3. MKRS-ja të themelojë Komisionin për punë vullnetare, sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016, për Punën Vullnetare të të Rinjve;
4. MKRS-ja të themelojë Komisionin e Përhershëm për Edukim Joformal të të Rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr.12/2010, për Edukimin Joformal të të Rinjve;
5. MKRS-ja në bashkëpunim me KQVR-në të organizojnë Konferencën Vjetore për Rininë e Kosovës, sipas Udhëzimit Administrativ nr.9/2010, për përgjegjësitë dhe

- procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të veprimit rinor në Kosovë;
6. Ministria e Financave në bazë të kërkesave të Komunave të ndajë kod të veçantë buxhetor për Rininë;
  7. MKRS-ja dhe Komunat të harmonizojnë strategjitë dhe planet e veprimit për çështjet rinore më qëllim të fuqizimit të rinisë.
  8. Komunat të sigurojnë financim të rregullt për Qendrat Rinore dhe KVRL-të;
  9. Komunat të bëjnë licencimin e së paku një Qendre Rinore;
  10. Komunat të shpallin konkurs për projektet rinore;
  11. Komunat të themelojnë komisione të pavarura për vlerësimin e projekteve të organizatave rinore.

Raporti me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë u votua nga anëtarët e Komisionit dhe si i tillë procedohet për miratim në seancë plenare.

#### **4. Të ndryshme**

Nait Hasani, paraqiti para anëtarëve të Komisionit shkresën e dërguar në emër të tij, të nënshkruar nga mbi 40 intelektualë, e cila përmbante shqetësimin e këtyre intelektualëve për zgjedhjet në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Kjo pikë u vendos që të diskutohet në mbledhjet e ardhshme të Komisionit.

Ismajl Kurteshi, paraqiti një raport nga Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim, në të cilën paraqiten çështjet e avancimeve akademike në Universitetin e Prishtinës, që sipas këtij nuk janë respektuar kriteret e avancimeve akademike dhe se është kërkuar mbështetja dhe ndihma e komisionit për të ndihmuar në rritjen e transparencës dhe hapjes së Universitetit publik të Prishtinës.

Bekim Haxhiu paraqiti kërkesën e Fakultetit të Mjekësisë për t'u pavarësuar dhe të themelohet si Universitet për Shkenca Mjekësore.

Nait Hasani, tha se Komisioni mund të mbështetë kërkesën e Fakultetit të Mjekësisë dhe t'ia procedojë në Ministrinë e Arsimit, pasi të kemi një kërkesë të tillë.

Ismajl Kurteshi kërkoi që kjo shkresë së pari të diskutohet në Komision, si çështje, duke u sqaruar arsyet dhe nevojat kryesore që shtyn këtë Fakultet të shndërrohet në Universitet.

Teuta Haxhiu, ngriti shqetësimin e saj për mosmarrjen e përgjigjes së shtruar për Ministrinë e Arsimit, sa i përket Ligjit për Arsimin e Lartë, ku tha se i intereson të dijë në cilën fazë është tani ky Ligj dhe se ky Ligj është tërhequr nga Kuvendi, pa marrë asnjë përgjigje dhe se kjo është mjaftë shqetësuese.

Ndërkaq, Bekim Haxhiu paraqiti shqetësimin e dy edukatorëve në Komunën e Fushë- Kosovës, pasi që atyre u është ndryshuar statusi i kontratës nga i përhershëm në atë më afat të caktuar dhe kjo është në kundërshtim me Ligjin e Punës. Arsyet që u janë dhënë atyre janë se ato kanë përfunduar shkollimin në fakultet privat, ani pse ka qenë i akredituar. Ai kërkoi që të konsultohet edhe Inspektorati i Punës, pasi që ky vendim shkel edhe dy ligje tjera që janë në ndërlidhje me këtë situatë.

Nait Hasani propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i arsimit për të diskutuar rreth vendimit për ata që kanë përfunduar masterin në fushat shkencave ekzakte, obligohen që për dy vite të ndjekin studimet në Fakultetin e Edukimit, si dhe lidhur me çështjen e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe mosakreditimin e programeve në Fakultetin Juridik dhe Edukimit si dhe gjendjen e zhvillimit në Universitetin e Prishtinës.

Me kërkesën e tij ish-ministri i Arsimit, Rexhep Osmani, paraqiti një ekspozitë të përgjithshme të zhvillimeve të arsimit që nga koha sa ai ka drejtuar MASHT-in. Në prezantimin e tij, ai tregoi për gjetjet dhe evidentimin e mosharmonizimit të ligjeve dhe statuteve të universiteteve me Ligjin për Arsimin e Lartë. Ai paraqiti vërejtjet e tij sa i përket përzgjedhjes së stafit akademik si dhe nostrifikimit të diplomave për ata që kanë përfunduar studimet jashtë vendit.

Osmani ngriti shqetësimin e tij në lidhje me paralelizmin dhe barabarësinë që po u bëhet Kolegjeve Universitare, Kolegjeve, Akademive etj, me Universitetet Publike. Në vazhdim të prezantimit të tij, ai tha se është Udhëzimi Administrativ që rregullon çështjen e Akreditimit që bartësit privat të Arsimit të Lartë duhet të kenë së paku 50% të stafit akademik me kontratë të plotë dhe nëse ai bartës i arsimit nuk i plotëson këto kriterë, ai nuk mund të akreditohet. Ai theksoi se këtë kriter asnjë prej bartësve privat nuk e ka plotësuar por as bartësit e publikë të Arsimit të Lartë nuk i plotësojnë këto kriterë që dalin nga udhëzimi administrativ.

Si shqetësim tjetër paraqiti atë që Agjencisë së Akreditimit, me ç'rast theksoi që grupi vlerësues është i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë, të cilët bëjnë raportet finale për akreditime, por që sipas tij ka lëshime të shumta, dhe ai kërkoi që në këtë grup të përfshihen edhe ekspertët vendorë.

Osmani, para anëtarëve të Komisionit, tha se një çështje skandaloze ka ndodhur në Universitetin e Prizrenit dhe ajo ka të bëjë me mosakreditimin e UPZ-së, për dy programe, atë për studim parashkollor dhe fillor. Ai shtoi se Qendra e Edukimit është bartur me këto dy fusha, të cilat u shndërruan në Njësi Akademike, me programet fillestare dhe kjo ka qenë e papranueshme për Agjencinë e Akreditimit dhe si rrjedhojë ka kërkuar në UPZ që t'i plotësojë kushtet.

Ai foli edhe për rezultatet e PISA-s, ku tha se kjo buron nga vite paraprake dhe se nuk duhet të kërkohet faj tek mësuesit, por tek ata që kanë organizuar përgatitjen dhe trajnimet për ta, mënyrën se si ata janë trajnuar dhe nga kush.

Në fjalën e saj, Shukrije Bytyçi shtroi pyetjen për ish-ministrin Osmani se sa e ndien ai vetën përgjegjës për gjendjen e arsimit në Kosovë, duke kritikuar vendimin për largimin e pedagogëve nga shkollat duke vlerësuar që puna e tyre do të ishte me e frytshme në cilësinë e pedagogëve sesa mësimdhënës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

***E Përgatiti:***

***Stafi mbështetës i Komisionit***

Kryetari i Komisionit,  
Nait Hasani